

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6706  
E enjte, 15 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

PSD-ja më 21 shtator  
proteston kundër  
Gjykatës Speciale | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)


## KURTI LAVDËROHET PËR NJË VIT E GJYSMË QEVERISJEJE



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të mërkurën se po shënojnë një vit e gjysmë të qeverisjes demokratike e përparimtare. Ai ka theksuar para kabinetit qeveritar se kthesa që kanë marrë drejt zhvillimit të shoqërisë nuk mund të jetë e qëndrueshme pa sundim të ligjit,

siguri juridike e zbatim të të drejtave të njeriut. "Pra, për ta jetësuar ndryshimin e mirëfilltë demokratik, vëmë theks mbi rendin dhe ligjin, parashikueshmërinë juridike dhe barazinë", ka deklaruar Kurti

## SPECIALJA KËRKON TA NDRYSHOJË AKTAKUZËN KUNDËR THAÇIT DHE TË TJERËVE: S'KA PROVA PËR KRIMIN NË FERIZAJ | FAQE 5



OSMANI, BISEDË TELEFONIKE ME  
HOMOLOGUN E LITUANISË, FLASIN  
PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE | FAQE 3

### AKTUALE



VON DER LEYEN: BE-ja NUK ËSHTË E  
KOMPLETUAR PA BALLKANIN  
PERËNDIMOR | F. 2

SËRISH KËRKOHEM SHKARKIMI I  
PROKURORËVE LIDHUR ME RASTIN E  
DHUNIMIT TË SË MITURËS | F. 6

VUÇIQI: KAM QENË PËR RISHKRIMIN  
E KUFIJVE, POR JO MË | F. 7

### EKONOMI



ZRRE-JA: 'ELEKTROSEVER'-I S'KA  
PËRMBUSHUR ASNJË KRITER | F. 8

BE-JA PËRGATIT PLAN PËR TA  
TEJKALUAR KRIZËN ENERGETIKE  
GJATË DIMRIT | F. 8

### SPORT



DRITA, TEPËR E FORTË PËR  
GJILANIN, FITON EDHE PRISHTINA | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Von der Leyen: BE-ja nuk është e kompletuar pa Ballkanin Perëndimor

**BRUKSEL, 14 SHTATOR** - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, insistoi që shtetet e Ballkanit Perëndimor, por edhe Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia, duhet të bëhen pjesë e familjes evropiane sepse, siç tha ajo, pa këto shtete "unioni ynë nuk do të jetë i kompletuar".

Von der Leyen mbajti më 14 shtator fjalimin vjetor në Parlamentin Evropian.

Shefja e KE-së tha se mënyra më e shpejtë për ta zgjeruar sundimin e demokracisë është duke i forcur lidhjet me shtetet demokratike në kontinentin evropian. "Kjo fillon me ato shtete që tashmë janë në rrugë drejt unionit tonë. Ne duhet të jemi në anën e tyre në secilin hap të kësaj rruge, sepse rruga drejt demokracisë së fuqishme dhe rruga drejt Bashkimit Evropian është e njëjtë. Prandaj, dua që njerëzit në Ballkanin Perëndimor, në Ukrainë, në Moldavi dhe në Gjeorgji ta dinë: ju jeni pjesë e familjes sonë, e ardhmja juaj është në union dhe unioni ynë nuk është i kompletuar pa ju", tha von der Leyen.

Shefja e Komisionit Evropian përmendi Ballkanin në disa pjesë të fjalimit të saj kur foli për nevojën që të rishqyrtohet politika e jashtme e BE-së. "Tash është koha për të investuar në forcën e demokracisë. Kjo punë fillon me grupin bazë të partnerëve që mendojnë si ne, me miqtë tanë në secilin komb demokratik në botë. Ne e shohim

botën me të njëjtin sy. Dhe ne duhet ta mobilizojmë fuqinë tonë kolektive", tha ajo.

Duke folur për rrugën e anëtarësimit në BE, presidentja e KE-së tha se mbështet idenë për formimin e një bashkësie politike evropiane, duke shtuar se propozimet për këtë temë do të paraqiten gjatë samitit të bllokut evropian.

Samiti i BE-së pritet të zhvillohet në tetor në Pragë, ku do të marrin pjesë liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor, por edhe liderët e vendeve evropiane që nuk janë në BE, sikurse Britania e Madhe, Norvegjia e të tjera.

Idenë për krijimin e një bashkësie politike evropiane e ka përmendur së pari presidenti i Francës, Emmanuel Macron, gjatë kryesimit të vendit të tij me Presidencën e BE-së në 6-mujorin e parë të vitit 2022. Idenë e Macronit e ka mbështetur edhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel.

Von der Leyen tha se krijimi i kësaj bashkësie nuk do të kishte qëllim zëvendësimin e zgjerimit të BE-së.

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që mbeten jashtë BE-së, negociatat për anëtarësim i kanë nisur Mali i Zi dhe Serbia, ndërsa në korrik edhe Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina kanë vetëm Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me BE-në, që është hapi i parë drejt anëtarësimit në bllok.



Pjesa më e madhe e fjalimit të von der Leyen iu kushtua pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia dhe pasojave që ka shkaktuar kjo luftë jo vetëm për Ukrainën, por edhe pjesën tjetër të botës, përfshirë rritjen e madhe të çmimeve të naftës dhe gazit.

E veshur me rroba me ngjyra të flamurit të Ukrainës, von der Leyen tha se BE-ja tashmë ka zvogëluar dukshëm varësinë

energjetike nga Rusia. Ajo rikujtoi se vitin e kaluar BE-ja merrte 40 për qind të gazit nga Rusia, ndërsa sivjet tha se kjo sasi ka rënë në 9 për qind.

Duke folur për sanksionet ndaj Rusisë, von der Leyen tha se ato po japin rezultate dhe se ato "janë aty për të mbetur". "[Presidenti i Rusisë, Vladimir] Putin do të dështojë, Ukraina dhe Evropa do të triumfojnë", tha ajo.

Shefja e Komisionit Evropian, po ashtu, prezantoi disa masa për ta ulur konsumin e energjisë gjatë dimrit, teksa e akuzoi Rusinë se po manipulon me tregun e energjisë, duke djegur gaz dhe duke rritur çmimet e energjisë në tregjet botërore.

Mysafire e veçantë gjatë fjalimit të von der Leyen në Parlamentin Evropian ishte bashkëshortja e presidentit të Ukrainës, Olena Zelenska.

## ShBA-ja: Rusia financoi fshehurazi parti në Shqipëri, Bosnjë e Mal të Zi



**WASHINGTON, 14 SHTATOR** - Rusia ka dhënë fshehurazi mbi 300 milionë dollarë për parti politike dhe kandidatë në dhjetëra vende që nga viti 2014. Sipas një zyrtari të lartë amerikan, presidenti rus Vladimir Putin është angazhuar në financim të fshehtë politik në mbarë botën.

Zyrtari që foli për medie tha se ky është përfundimi i një raporti të komunitetit amerikan të zbulimit, i cili ka analizuar financimet e Rusisë "në mbi 24 vende gjatë viteve të fundit".

Sipas një burimi me njohuri mbi raportin, Shqipëria është një nga këto vende. "Në Shqipëri, Rusia i dha rreth gjysmë milioni dollarë Partisë Demokratike në vitin 2017 përmes kompanive fantazmë", tha burimi i qeverisë amerikane.

Burimi nuk dha hollësi të mëtejshme për rastin e Shqipërisë, por viti 2017, emri i Partisë Demokratike dhe shifra e përmendur prej qindra mijëra dollarësh, përkojnë me hetimet që janë hapur në Shqipëri në atë kohë

ndaj PD-së, bazuar në deklaratimet që firma lobuese amerikane "Muzin Capitol Partners" ka raportuar se ka marrë nga PD-ja. Firma lobuese amerikane ka deklaruar në vitin 2018 në Departamentin Amerikan të Drejtësisë, se ajo ka marrë gjithsej tri pagesa, në një shumë prej 675 mijë dollarësh, për punën e saj në favor të Partisë Demokratike në vitin 2017.

Veç Shqipërisë, sipas burimit të administratës amerikane, në raport përmenden edhe Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi.

Raporti përmend financimin e fushatës së udhëheqësit të serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik, për zgjedhjet e vitit 2018, si dhe fonde për partinë pro-ruse në Mal të Zi, Fronti Demokratik.

Zyrtari amerikan tha për mediet se Shtetet e Bashkuara janë angazhuar me aleatët dhe partnerët për të mbledhur më shumë informacion për trezikun e financimit rus për partitë politike. (Voa)

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

## Telekomi i Kosovës, cak i sulmeve kibernetike

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Telekom i Kosovës ka njoftuar se dy në ditët e fundit është përballur me sulme kibernetike. Në një njoftim për medie, operatori i shërbimeve mobile, "Vala", bëri me dije se edhe pse "sulmet kanë vazhduar", Telekom i ka arritur t'i kthejë shërbimet e prekura të internetit në rrjetin e telefonisë mobile dhe fikse.

Telekomi i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare.

Kjo është hera e dytë gjatë këtij muaji që institucionet në Kosovë raportojnë se kanë qenë cak i sulmeve kibernetike.

Më 6 shtator Qeveria e Kosovës bëri me dije se uebfaqet e institucioneve shtetërore kanë

qenë cak i një sulmi kibernetik. Qeveria tha se ky sulm është kryer jashtë vendit.

Edhe shtetet e tjera të rajonit së fundmi janë përballur me sulme kibernetike. Shqipëria ka raportuar një të tillë në korrik dhe një në shtator. Për të dyja sulmet, Tirana ka fajësuar Iranin dhe më 7 shtator ka shkëputur raportet diplomatike me Teheranin.



## PSD-ja më 21 shtator proteston kundër Gjykatës Speciale

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka folur për vizitën e kryetares së Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, e cila më 21 shtator do të mbajë një takim me përfaqësues të shoqërisë civile në Gjilan në kuadër të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim. Ai në një konferencë për medie ka thënë se më 21 shtator në orën 10:00 PSD-ja do të mbajë protestë kundër vizitës së kryetares së Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova dhe kësaj gjykatë. Molliqaj, gjithashtu, ka ftuar që të marrin pjesë në protestë edhe veteranët dhe ata qytetarë që janë mbështetës të lirisë. "Më 21 shtator në orën 10:00, në vendin ku do të mbahet ky takim, do të kemi protestë. Ftojme veteranët dhe mbështetësit e lirisë që të jemi bashkë. Protesta duhet të jetë gjithëpërfshirëse", u shpreh kryetari i PSD-së.

Ai ka thënë se kjo gjykatë është politike dhe rrjedhimisht ka pasur në vazhdimësi veprime politike. "Edhe më herët kishte paralajmëruar se do ta realizojë këtë vizitë, ku më pas kishte thënë se kjo vizitë do të shtyhet dhe do të mbahet më 21 shtator, praktikisht sot një javë, e mërkurë, ora 10:00, në Gjilan. Që nga fillimi i këtyre dhomave, e kemi thënë duke e cilësuar se kjo gjykatë është politike dhe rrjedhimisht ka pasur në vazhdimësi veprime politike. Është tërësisht e papranueshme për sistemet demokratike, ku janë të ndara pushtetet të kemi këso lloj veprime të gjykatës. Nuk besoj që keni dëgjuar



ndonjëherë që një gjykatë të flasë për sondazhe dhe mbështetjen që ajo gjykatë e ka në sondazhe, ose në matje të opinionit publik. Unë nuk kam dëgjuar në jetën time e s'kam lexuar që gjykata të vendeve demokratike të flasin për mbështetje ose jo popullore", ka thënë ai.

Sipas Molliqajt, asnjëherë nuk ka dëgjuar që gjykatat të mbajnë takime të mbyllura. "Që edhe medie dhe gazetarëve t'u imponohet që bëjnë kërkesë

paraprakisht për pjesëmarrje dhe të tjerëve t'u thonë që mund ta kenë linkun e transmetimit live të takimit. Kur ishte për herë të parë në Kosovë na pati ftuar të kemi një takim të përbashkët, ndërsa kësaj radhe kur e pati paralajmëruar takimin ne i bëmë ftesë zyrtare dhe u shkruam Dhomave të Specializuara dhe morëm një përgjigje negative", ka theksuar Molliqaj.

Ai ka thënë se kërkesat e kësaj gjykatë janë më të larta sesa ato

të Hagës për krime lufte. "E dini që i kemi pasur dy grupe të UÇK-së në Hagë, ai i Fatmir Limaj dhe Ramush Haradinaj. Për këta dy liderë kërkesa e asaj prokurorie ka qenë 20 vjet, por janë liruar. Tani për një udhëheqës të rangut të mesëm, kërkesa është 35 vjet burgim. Këto veprime janë të dëmshme, të rrezikshme dhe po ndodhin pikërisht në këtë kohë kur po normalizohet marrëdhënia e Kosovës me Serbinë, duke mos e njohur Serbia Kosovën. Dhe në

kohën kur po shohim se të gjitha dëshmitë janë të mbledhura dhe të bartura përmes informatorëve të strukturave paralele ilegale dhe joilegale të Serbisë për krime lufte, jorastësisht në këtë kohë kemi edhe kryeministër, presidente dhe kryetar Kuvendi që nuk po veprojnë. Ajo që i mbetet Kosovës dhe secilit prej nesh është që ta shprehim pakënaqësinë tonë ndaj kësaj dukurie negative", ka thënë Molliqaj.

## Osmani, bisedë telefonike me homologun e Lituanisë, flasin për liberalizim të vizave

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar të mërkurën një telefonatë me presidentin e Letonisë, Egils Levits, si pjesë e konsultimeve të vazhdueshme me homologë. Presidentja Osmani e ka

falënderuar presidentin Levits për mbështetjen që Letonia po i jep Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet. "Bisedova me presidentin e Letonisë, Egils Levits, si pjesë e konsultimeve të mia të rregullta me homologët. Diskutuam për çështje dypalëshe, urgjencën

për liberalizim të vizave për Kosovën dhe rëndësinë për vazhdimin e mbështetjes për Ukrainën", ka thënë presidentja Osmani, duke shtuar se është mirënjohëse për mbështetjen e palëkundur të Letonisë për integrimin tonë euroatlantik.





Foto: Zyra e Kryeministrit të Kosovës

# Kurti lavdërohet për një vit e gjysmë qeverisjeje

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të mërkurën se po shënojnë një vit e gjysmë të qeverisjes demokratike e përparimtare. Ai ka theksuar para kabinetit qeveritar se kthesa që kanë marrë drejt zhvillimit të shoqërisë nuk mund të jetë e qëndrueshme pa sundim të ligjit, siguri juridike e zbatim të të drejtave të njeriut. “Pra, për ta jetësuar ndryshimin e mirëfilltë demokratik, vëmë theks mbi rendin dhe ligjin, parashikueshmërinë juridike dhe barazinë”, ka deklaruar Kurti

**EPOKA  
ERE****Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 14 shtator - Në mbledhjen e 96 të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Albin Kurti ka thënë se në javën e ardhshme shënojnë një vit e gjysmë të qeverisjes demokratike dhe përparimtare. “Kthesa që kemi marrë drejt zhvillimit të shoqërisë nuk mund të jetë e qëndrueshme pa sundim të ligjit, siguri juridike e zbatim të të drejtave të njeriut. Pra, për ta jetësuar ndryshimin e mirëfilltë demokratik vëmë theks mbi rendin dhe ligjin, parashikueshmërinë juridike dhe barazinë”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se vetëm në 1/3 e mandatit kanë kaluar mbi 150 projektligje. Ndërkaq, sipas kryeministrit, në gjysmën e parë të këtij viti janë miratuar

87 sosh në Kuvendin e Republikës. “Këtë javë ka rifilluar punën Kuvendi. Nesër do ta kemi seancën e parë të sesionit vjeshtor dhe urojmë që ky sesion të jetë edhe më i suksesshëm. Shifrat rekorde korrespondojnë me vullnetin dhe kontributin ndaj fuqizimit të shtetit mbi parimet më të mira që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore dhe pamundësojnë shmangien nga zbatimi i ligjit”, është shprehur ai.

Kurti ka thënë se përmes projektligjeve të miratuara kanë fuqizuar mekanizmat për luftimin e krimit dhe të korrupsionit nëpërmjet reformës në Këshillin Prokurorial, deklarimin më efikas dhe transparent të pasurisë, potencimin e rolit parandalues të Agjencisë

Kundër Korrupsionit dhe inicimit të konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme. “Gjithashtu, kemi ngritur llogaridhënien ndaj qytetarit përmes Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike e atij për Qeverinë. Për të siguruar efikasitet në trajtimin e kontesteve komerciale kemi themeluar Gjykatën Komerciale, kurse sot do ta trajtojmë Projektligjin për Prokurorinë Speciale e atë për Prokurorin e Shtetit”, ka thënë ai.

Kryeministri ka pohuar se, përveç vettingut si reformë thelbësore në sistemin e drejtësisë, të cilën thotë se ua kanë besuar përfaqësuesve të popullit, vazhdojnë trajtimin e temës nga e cila varet stabiliteti dhe kohezioni social. “Spektri i konfliktit të dhunshëm, luftës e

i gjenocidit, ende shtrihet nëpër Evropë, duke bërë kështu iluzor zbatimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Funksionimi joadekuat i institucioneve përgjegjëse apo mungesa e tyre, shpie te pamundësia e rindërtimit të paqes. Historia na mëson që zgjidhjet afatgjatë janë të paarrtshme atëherë kur nuk bazohen në parimet e drejtësisë, reparacioneve, të vërtetës dhe të garantimit për mospërsëritje. Është detyrë e qeverisë që, mbi të vërtetën, të ndërtojë mekanizma dhe institucione për ballafaqimin me të kaluarën dhe krijimin e kujtesës kolektive e cila do të na shërbejë jo vetëm neve, por edhe gjeneratave të ardhshme. Për këtë kam kënaqësinë që sot ta hap mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, e cila i referohet miratimit të Projektligjit për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se dokumentimi dhe hulumtimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë janë thelb i këtij projektligji. “Në të gjitha deklaratimet e mia që

kam pasur lidhur me këtë temë, kam potencuar që krimet e kryera dhe dëmet e shkaktuara duhen adresuar. Ato janë parakusht për paqe të qëndrueshme, stabilitet afatgjatë e zhvillim të mëtutjeshëm të shoqërisë. Një shoqëri që nuk harron sepse e institucionalizon kujtesën dhe që mbi supet e përgjegjësisë institucionale gjen drejtësinë, si parakusht për pajtimin dhe jetesën e dinjitetshme e të përbashkët”, ka deklaruar Kurti, duke bërë me dije se Instituti për Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë do të themelohet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. “Dokumentimi i krimeve të kryera gjatë luftës do të jetë në fokus të veprimit të Zyrës së Kryeministrit. Vetëm me respektimin e duhur të së kaluarës mund të kemi një të ardhme të ndritur”, ka thënë kryeministri Kurti.

Qeveria e Kosovës në këtë mbledhje ka miratuar dymbëdhjetë projektligje, tri nisma për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe trembëdhjetë vendime të tjera.

# Specialja kërkon ta ndryshojë aktakuzën kundër Thaçit dhe të tjerëve: S'ka prova për krimin në Ferizaj

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Gjykatën Speciale në Hagë, përmes një kërkesë drejtuar gjykatës, ka kërkuar leje ndryshimin e aktakuzës në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ndryshimi i aktakuzës në këtë rast është për ta larguar pretendimin për një krim të kryer kundër një viktime në një shtëpi rreth Ferizajt

HAGË, 14 SHTATOR - Përmes një kërkesë drejtuar gjykatës për rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka kërkuar leje për ta ndryshuar aktakuzën për t'i hequr pretendimet e krimeve të kryera kundër, së paku, një viktime rreth [redaktuar] vitit 1999 në një shtëpi në apo rreth Ferizajt. Sipas shkrësës, ZPS së fundi mori një vendim përfundimtar që të mos mbështetet në dëshmitë e... [redaktuar] dhe konsideron se tani nuk ka prova të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e Ferizajt. "Nga vetë natyra e tyre dhe në këtë fazë të procedimit, ndryshimet e kërkuara nuk paragjykojnë ose nuk janë në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarit dhe duhet të aprovohen. Duke vënë në dukje afatin e 30 shtatorit 2022 për ngritjen e një aktakuzë të ndryshuar, ZPS-ja kërkon, në interes të efikasitetit, një orar të përshpejtuar të informimit për të mundësuar ngritjen e një aktakuzë të ndryshuar që përfshin, gjithashtu, çdo ndryshim të autorizuar si rezultat i kësaj kërkesë", thuhet në këtë shkrësë.

Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqi. Prokuroria pretendon se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë dhe Semetishtë.

Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen se ndodhën në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, trajtimi mizor ose çnjerëzor, tortura, vrasja, ndërkaq si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, veprat e tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin.

Kurse për krimet që pretendon që ndodhën në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen, ndërsa si krime kundër njerëzimit ka listuar burgimin, veprat e tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup



Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë.

Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi më 11 nëntor. Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020. Sipas akuzës, së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe

eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin kundërshtarë.

"Ndër këta kundërshtarë përfshiheshin personat që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione shtetërore të RFJ-së, ose që (b) ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera (bashkërisht, 'kundërshtarët'). Ky qëllim i përbashkët përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me

forcë të personave", thuhet në aktakuzë.

Më tutje, në aktakuzë përmenden edhe Azem Syla, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Shukri Buja, Latif Gashi dhe Sabit Geci. Sipas aktakuzës, të akuzuarit, bashkë me udhëheqësit e tjerë të UÇK-së, kontribuan në arritjen e qëllimit të përbashkët. "Si alternativë, disa ose të gjithë këta individë nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, por u përdorën nga anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (së bashku me anëtarët e NKP-së, bashkërisht 'anëtarët dhe instrumentet e NKP-së')", thotë akti akuzues. /BetimipërDrejtësi

## "Salih Mustafa s'ka vrarë e as urdhëruar vrasjen e askujt"

HAGË, 14 SHTATOR - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, të mërkurën janë dëgjuar deklaratat përmbyllëse të mbrojtjes së viktimave dhe mbrojtjes së Salih Mustafës.

Avokati i këtij të fundit ka deklaruar se klienti i tij asnjëherë nuk ka vrarë apo ka urdhëruar vrasjen e ndonjë personi apo edhe torturuar, keqtrajtuar apo ndaluar ndonjë person ashtu siç po pretendon Zyra e Prokurorisë së Specializuar.

Avokati Julius von Bonne, në fjalën e tij përmbyllëse, ka deklaruar se të gjitha aktakuzat ndaj Salih Mustafës janë të lidhura me një njësi të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i njohur si BIA, i cili operonte në kompleksin në Zllash. Megjithatë, sipas tij, nuk ka asnjë dokumentacion, sa u takon njerëzve që ishin pjesë e BIA-së, nuk kishte as regjistrim, as trajnim, as grada e uniforma dhe se njerëzit ishin të angazhuar për ta çliruar vendin e tyre nga një prej regjimeve më shtypëse.

"I tërë nocioni i këtij kompleksi që përdorej si bazë për BIA është i



gabuar. Njerëzit e BIA-së nuk kishin pushtet atje. I gjithë kompleksi është përdorur si vend i sigurt për refugjatët, për personat e zhvendosur brenda vendit që qëndronin atje në një vend të sigurt", ka treguar Bonne para trupit gjykues në Gjykatën Speciale.

Ai tha se asnjë prej njerëzve që ka qëndruar në Zllash nuk ka thënë që BIA operonte apo drejtonte

këtë kompleks ose nuk ka thënë që ishte BIA që kishte monopol të plotë në këtë kompleks. Sipas avokatit, është i rremë pretendimi që kompleksi në Zllash ka qenë vendi ku njerëzit e caktuar janë marrë në pyetje dhe janë keqtrajtuar më pastaj.

"Personat e BIA-së nuk ishin pjesë e asnjë komande të asnjë brigade. Ishte njësi tërësisht e veçantë dhe me siguri ata i kanë ndihmuar

përpjekjet e luftës në tërësi", ka shtuar ai.

Avokati i Mustafës ka bërë të qartë se asnjë person i vetëm i BIA-s, as vetëm, as në mënyrë të përbashkët me ushtarë të tjerë të UÇK-së, policë ushtarakë, nuk kanë pasur qëllim ta ndalojnë, keqtrajtojnë mizorisht, torturojnë apo vrasin dikë. "Ata nuk kanë kryer asnjë prej krimeve të pretenduara. Zoti Mustafa i rrëzon

me vendosmëri akuzat. Nuk kishte asnjë njohuri për krimet në aktakuzë", ka thënë avokati.

Në anën tjetër, përgjatë deklaratës së saj përfundimtare, mbrojtësja e viktimave, Anni Pues, ka thënë se arrestimi i viktimave ka qenë i padrejtë. Sipas saj, ndalimi arbitrar, për të cilën po akuzohet Mustafa, është dhunim i të drejtave të njeriut. Dëshmitë, sipas Pues, tregojnë qartë përfshirjen e drejtpërdrejtë të Salih Mustafës në krime kundër njerëzimit.

Mbrojtësja e viktimave, Anni Pues, deklaroi se njësi BIA i ka ndaluar ata persona që për ta ishin të padëshiruar, i ka përshkruar si spiunë apo hajdut për shkak se nuk i pëlqenin pikëpamjet e tyre politike dhe kjo formë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale është pjesë e së drejtës zakonore.

Një ditë më parë Zyra e Prokurorit të Specializuar në kuadër të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ka kërkuar që Salih Mustafa të dënohet me 35 vjet heqje lirie.

## Prokuroria e Pejës për nëntë muaj akuzon 154 persona për dhunë në familje

Pejë, 14 shtator - Prokuroria Themelore në Pejë ka bërë me dije se gjatë periudhës kohore janar-shtator të këtij viti ka ngritur 146 aktakuza kundër 15 personave për veprën penale "Dhunë në familje". Në periudhën nëntëmuajore të këtij viti, Prokuroria Themelore në Pejë ka akuzuar 133 persona të gjinisë mashkullore, kurse 17

janë nga gjinia femërore. Nëpërmjet një kumtese për medie thuhet se gjatë kësaj kohe janë trajtuar si viktime të dhunës në familje gjithsej 154 persona, prej tyre 125 të gjinisë femërore, kurse 29 janë viktime të gjinisë mashkullore. Gjatë trajtimit të këtyre rasteve nga Prokurori i Shtetit janë bërë 35 kërkesa për caktimin e masës

së paraburgimit për personat e pandehur dhe në gjashtë raste është propozuar për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Prokuroria Themelore në Pejë i inkurajon të gjithë viktimat e rasteve të dhunës në familje që t'i raportojnë rastet në këtë prokurori apo në Policinë e Kosovës.



## Sërish kërkohet shkarkimi i prokurorëve lidhur me rastin e dhunimit të së miturës



PRISHTINË, 14 SHTATOR - Para ndërtesës së Këshillit Prokurorial në Prishtinë të mërkurën është mbajtur një protestë simbolike, në të cilën është kërkuar shkarkimi i prokurorit Ruhan Salihu dhe kryeprokurorit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Kujtim Munishi, lidhur me dëshmimin për ta parandaluar rastin e dhunimit të një të miture.

Anita Mjeku nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist tha se këta dy prokurorë janë përgjegjës për mosparandalimin e dhunimit

të një të miture.

Lajmi për dhunimin e 11 vjeçes në Prishtinë është publikuar muajin e kaluar. Gjatë këtij aksioni në hyrjen e Këshillit Prokurorial janë vendosur shirita të policisë me emrat e dy prokurorëve. Organizatorët kanë thënë se shiritat simbolizojnë "skenën e krimit". "Dhunimi i vajzës 11-vjeçare nga pesë burra muajin e kaluar ishte ngjarje që mund të parandalohet. Kjo nuk do të ndodhte nëse prokurori i rastit, Ruhan Salihu, nuk do ta bënte punën e tij në qershor, kur dhunimi i

të miturës nga gjashtë persona u raportua. Ne jemi të vetëdijshëm se të paktën dy raste të dhunës seksuale, në të cilat Ruhan Salihu ka qenë prokuror, ai nuk i ka trajtuar me seriozitet ato", ka thënë Mjeku. Dorëheqjen e Munishit e ka kërkuar më 4 shtator edhe ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu. Ajo kishte vlerësuar se duhet të merren masa kundër "prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk kryejnë detyrat e tyre". Në Kosovë janë mbajtur një sërë protestash pas dhunimit

të së miturës. Protestuesit kanë kërkuar përgjegjësi nga organet e drejtësisë. Mjeku ka shtuar se protestat para Këshillit Prokurorial të Kosovës do të vazhdojnë derisa të shkarkohen prokurori Salihu dhe Munishi. Protestuesit, po ashtu, po kërkojnë që rasti i dhunimit të së miturës të kalojë në Prokurorinë Speciale. Më 5 shtator ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se 11 vjeçja, që është dhunuar nga pesë persona në Prishtinë më 27 gusht, ishte abuzuar seksualisht për më

shumë se një vit. Deri më tani autoritetet kanë caktuar masën e paraburgimit prej një muaji për 11 të dyshuarit për dy rastet e dhunimit të 11-vjeçes.

Policia e Kosovës ka thënë se çdo ditë raportohen dhjetëra raste të dhunimit seksual. Ndërkaq, sipas të dhënave të Rrjetit të Grave, numri më i madh i dhunimeve janë vajzat e moshës 13 deri në 16 vjeç. Kodi Penal i Kosovës parasheh dënime nga 2 deri në 15 vjet burgim për dhunimin dhe sulme të tjera seksuale.

## Kurti nënshkruan në "Librin e ngushëllimeve" për mbretëreshën Elizabetë

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Në librin e zisë, të hapur në Ambasadën e Britanisë së Madhe në Kosovë, kryeministri Albin Kurti ka shprehur respektin dhe nderimin për lartmadhërinë e saj, mbretëreshën Elizabeta II. Në emër të popullit të Kosovës

dhe në emrin personal, kryeministri Kurti u ka shprehur ngushëllime të sinqerta familjes mbretërore dhe popullit të Mbretërisë së Bashkuar për vdekjen e madhërisë së saj, mbretëreshës Elizabeta II. "Mbretëresha

Elizabeta II ishte një udhëheqëse shembullore, por e quante veten edhe shërbëtoreshë të popullit. Trashëgimi e madhe dhe udhëzimi i madh. U preftë në paqe!", ka shkruar kryeministri Kurti.



## Vuçiqi: Kam qenë për rishkrimin e kufijve, por jo më

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se rishkrimin e kufijve me Kosovën dikur e ka parë si zgjedhje, por ka shtuar se këtë nuk e mendon më, pasi "rrethanat tani kanë ndryshuar". Vuçiqi i bëri komentet në një seancë të Kuvendit të Serbisë, ku për të dytën ditë me radhë u diskutua për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Duke u përgjigjur në pyetjet e

deputetëve se cila është zgjidhja e tij për Kosovën, Vuçiqi tha se situata politike ka ndryshuar "jo vetëm me vullnetin tonë, por edhe me vullnetin e fuqive të mëdha". "Pozicioni nuk mund të jetë i njëjtë para dhe pas vitit 1999, as pas vitit 2008, as pas vitit 2010", ka thënë Vuçiqi, duke shtuar se "disa veprime e kanë vështirësuar pozitën e tij". "Nuk po fsheh asgjë, kam menduar se demarkacioni i kufirit është zgjidhje. E kam kuptuar se kjo është e pamundur, sepse të gjithë më jeni hedhur në kokë",

ka deklaruar Vuçiqi, pa ofruar më shumë detaje. Ideja e ndryshimit të kufijve, si zgjidhje e mundshme për mosmarrëveshjet në mes të Kosovës dhe Serbisë, është shpalosur më 2018 nga vetë presidentët e atëhershëm të këtyre dy vendeve, Vuçiqi dhe Thaçi. Megjithatë, kjo ide ka hasur në reagime për dhe kundër në Kosovë dhe Serbi dhe në qarqet ndërkombëtare. Kritikët kanë thënë se ajo do të mund të shkaktonte efekt domino edhe midis vendeve të tjera që kanë çështje të hapura.



## Fillon trajnimi i avancuar i aftësive juridike të prokurorëve nga rajoni i Mitrovicës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Ka filluar trajnimi treditur për aftësitë e avancuara ligjore të prokurorëve nga rajoni i Mitrovicës, mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në të cilin po marrin pjesë ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Ismet Ujkani, si dhe

prokurorët dhe stafi i kësaj prokurorie.

Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, ka falënderuar OSBE-në për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Sipas tij, është tepër e rëndësishme të qëndrojmë bashkë si profesionistë për t'i luftuar kriminelët dhe grupet kriminale si dhe i ka porositur prokurorët e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë që të vazhdojnë të punojnë në mënyrë të pavarur

dhe pa ndikime.

Po sipas Kelmendit, Prokuroria Themelore në Mitrovicë do ta ketë përkrahjen e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për kryerjen e punëve dhe angazhimeve të përditshme. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Ismet Ujkani, ka thënë se pavarësisht prej kushteve në të cilat punon kjo prokurori, duke iu falënderuar angazhimit dhe bashkëpunimit mes prokurorëve dhe stafit, rezultatet e punës janë të mira.

Sipas Ujkanit, ky trajnim i avancuar do të kontribuojë në ngritjen profesionale të prokurorëve, zgjerimin e aftësive të prokurorëve, si dhe raporteve të të gjithë të punësuarve në këtë institucion.

Në këtë trajnim, në cilësinë e ligjëruesit, po ligjërojnë prokurorët e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Naim Beka dhe Radica Milic.

Në trajnim do të ligjërohet për Kapitullin XIV nga Kodi i Procedurës Penale -Procedura

Alternative me temën "Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë", si dhe Kapitulli XXI i Kodit Penal - Veprat penale kundër martesës dhe familjes, me temën

"Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet". Në fund të trajnimit treditur do të nxirret përmbledhja e diskutimeve dhe konkluzioneve të këtij trajnimi, i cili do t'u ndihmojë prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për kryerjen e punëve të përditshme.

## 179 raste aktive me Covid në Kosovë

Prishtinë, 14 shtator - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit,

pas 249 testimeve, janë konfirmuar 19 raste të reja me Covid-19. Sipas këtij raporti të

MSh-së, janë shëruar 29 persona, ndërsa 2 raste aktive me Covid janë 179. Në 24 orët

e fundit vaksinën kundër Covidit e kanë marrë 31 persona.



## ZRRE-ja: 'Elektrosever'-i s'ka përmbushur asnjë kriter

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kompania serbe "Elektrosever", e licencuar për furnizimin e veriut të Kosovës me energji elektrike, nuk i ka plotësuar ende kushtet që ia përcakton udhërrëfyesi për Marrëveshjen për Energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Ndonëse i kanë mbetur më pak se tri javë për një gjë të tillë, nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në Kosovë thonë për "Radion Evropa e Lirë" se, në bazë të informacioneve që kanë, asnjë nga kriteret e përcaktuara "nuk është përmbushur".

Marrëveshja për Energji parasheh që qytetarët në veri të Kosovës të paguajnë për rrymën e shpenzuar nga vjeshta e këtij viti për herë të parë pas më shumë se dy dekadash.

REL e ka pyetur edhe kompaninë "Elektrosever" për zbatimin e kriterëve të marrëveshjes por, deri në publikimin e këtij teksti, nuk ka marrë përgjigje prej saj.

Udhërrëfyesi për Marrëveshjen e Energjisë përcakton se në rast të mosveprimit me kushtet e caktuara brenda 100 ditësh nga licencimi, "Elektrosever"-it mund t'i pezullohet ose tërhiqet

licenca nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Megjithatë, një vendim i tillë do të duhej të diskutohej paraprakisht mes palëve, përkatësisht në mes të Kosovës dhe Serbisë.

ZRRE-ja i ka miratuar licencën "Elektrosever"-it më 24 qershor.

"Elektrosever"-i është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë - EPS (Elektroprivreda Srbije), por në Kosovë është themeluar me ligje të Kosovës. Kjo kompani është paraparë ta bëjë edhe furnizimin, edhe faturimin e rrymës së shpenzuar në veri të Kosovës, pjesë e banuar me shumicë serbe.

Licencimi i saj është paraparë me Marrëveshjen midis Kosovës dhe Serbisë për Energjinë, e cila është arritur në vitin 2013, por pajtimi për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo udhërrëfyesin, është arritur më 21 qershor.

### Kushtet që duhen plotësuar

Vetëm tri ditë pas, bazuar në kushtet e udhërrëfyesit, ZRRE-ja ka licencuar "Elektrosever"-in. Brenda dhjetë ditësh nga licencimi është dashur që

"Elektrosever"-i të nënshkruajë marrëveshje teknike me Kompaninë për Distribuimin e Energjisë Elektrike në Kosovë - KEDS dhe me Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike - KOSTT në mënyrë që të operojë në tregun e Kosovës. Pas marrëveshjes me KOSTT-in, brenda 15 ditësh "Elektrosever"-i do të pajisej me disa kode identifikuese për kryerjen e aktiviteteve. Ndërsa 30 ditë pas kësaj, KEDS-i dhe KOSTT-i do të fitonin qasje te nënstacioni i diskutueshëm i Vallaçit si dhe në infrastrukturën tjetër për shpërndarje të rrymës.

Në udhërrëfyes, po ashtu, thuhet se brenda 45-ditësh KOSTT-i dhe KEDS-i, në konsultim me "Elektrosever"-in, do t'i dorëzonin ZRRE-së një plan investimi, kostot e mirëmbajtjes, si dhe humbjet në rrjet, bazuar në analizën e infrastrukturës ekzistuese. Brenda 21 ditësh pastaj ZRRE-ja do t'i miratonte këto plane në parim.

KOSTT-i konfirmoi për REL-in se pjesën e marrëveshjes me të, "Elektrosever"-i nuk e ka përmbushur. "Elektrosever"-i ende nuk i ka siguruar KOSTT-

it të dhënat për konsumatorët e energjisë elektrike", tha KOSTT. E pyetur nga REL nëse ka dështuar zbatimi i udhërrëfyesit, ZRRE-ja tha se "ende është herët të paragjykojmë këtë".

Në një email dërguar Zyrës së Kryeministrit të Kosovës më 9 shtator, me pyetjen se çfarë hapash mund të ndërmerren ndaj kompanisë "Elektrosever" në rast të mospërmbushjes së kushteve, REL, po ashtu, nuk ka marrë përgjigje.

Eksperti i çështjeve energjetike, Ethem Çeku, njëherësh ish-ministër i Energjisë në Kosovë, thotë se nuk ka qenë e pritur që "Elektrosever"-i t'i plotësojë kushtet e parashtruara. Këtë e justifikon me faktin se zbatimi i Marrëveshjes për Energjinë është zvarritur qysh në vitin 2013, kur edhe është nënshkruar. "Vetëm trysnia e madhe e faktorit ndërkombëtar, në këtë rast e BE-së dhe ShBA-së, mund ta detyrojë [Elektrosever-in] t'i pranojë dhe kryejë obligimet sipas kontratës", ka thënë Çeku për Radion Evropa e Lirë.

Nevoja për një marrëveshje për energjinë ka lindur pasi qytetarët në veri të Kosovës, shumica serbë, nuk kanë

paguar për rrymën e shpenzuar që prej përfundimit të luftës më 1999. Refuzimi ka ardhur si pasojë e mosbindjes qytetare, por edhe ndikimit të strukturave të ndryshme atje, që kanë operuar nën dirigjimin e Serbisë. Nga fundi i luftës deri më 2017, rrymën e shpenzuar në veri e kanë paguar qytetarët e pjesëve të tjera të Kosovës të cilët kanë marrë fatura me rritje. Nga 2017-ta e këndeje, për shkak të ankesave të shumta të qytetarëve, përgjegjësia për pagesën ka kaluar te Qeveria e Kosovës. Me Marrëveshjen për Energjinë është paraparë që kompania "Elektrosever" ta bëjë edhe furnizimin, edhe faturimin e rrymës së shpenzuar në veri.

"Elektrosever"-i nuk do të prodhonte rrymë, por do ta blinte atë, qoftë nga Korporata Energjetike e Kosovës apo nga një tjetër ofertues në tregun ndërkombëtar, ndërsa inkasimin do ta bënte vetë.

Në një intervistë për REL më 8 gusht, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se në rast të dështimit të marrëveshjes, Qeveria e Kosovës nuk do të ketë mundësi që në vjeshtë të vazhdojë ta paguajë rrymën në veri.



## BE-ja përgatit plan për ta tejkaluar krizën energjetike gjatë dimrit

BRUKSEL, 14 SHTATOR - Bashkimi Evropian pritet ta prezantojë pakon e re të masave që kanë për qëllim uljen e çmimit të gazit dhe energjisë të cilat po rritin inflacionin në nivel rekord. Rritja e çmimeve po pengon aktivitetin industrial dhe po shtrenjton faturat për qytetarët para sezonit të dimrit.

Në fillim të këtij muaji Rusia njoftoi se nuk do ta rihapë gazsjellësin kryesor që sjell gaz në Evropë, "Nord Stream II". Ky është vendimi i fundit në një seri vendimesh që kanë kufizuar furnizimet e energjisë ruse për Evropën. Moska ka thënë se këto kufizime po bëhen në kundërpërgjigje të sanksioneve që Perëndimi ka

vendosur ndaj Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Komisioni Evropian pritet që t'i paraqesë propozimet e BE-së dhe më pas qeveritë e shteteve anëtare mund të punojnë mbi detajet e propozimeve dhe ka të ngjarë që t'i miratojnë masat më 30 shtator në takimin e ministrave të Energjisë.





# Gjermania, pse është e rrezikshme të jesh një vend i pasur ekonomikisht por i dobët ushtarakisht



Nga George FRIEDMAN

Ministrja e Jashtme gjermane, deklaroi javën e kaluar se vendi i saj nuk mund të dërgojë më shumë nga armët e veta në Ukrainë, pasi ushtria gjermane ka sasi të pakta në dispozicion. Nëse kjo histori është e vërtetë, kjo do të thotë se Gjermania, me ekonominë më të madhe në Evropë, nuk i ka aktualisht mundësitë për të prodhuar me shpejtësi më shumë armë, pavarësisht se ka premtuar para për prodhimin e armëve për Ukrainën.

Paratë kanë rëndësi, por vetëm në një masë të caktuar. Kapaciteti i vendeve të tjera të NATO-s për t'i dërguar armë Ukrainës, ka gjithashtu kufizime në aspektin e prodhimit. Edhe pse problemi gjerman ishte parashikuar që nga fillimi i luftës në Ukrainë, dhe Gjermania ka dhënë para në vend të armëve, këtu duhen theksuar disa fakte.

Së pari, sikurse dihet gjerësisht, Evropa dhe Gjermania po përballeshin me një dimër shumë të vështirë për shkak të rënies së eksporteve ruse të energjisë. Ka të ngjarë që "defiçiti" gjerman i

armëve të jetë një lëshim për Rusinë, por ndoshta jo: Berlini nuk mund ta bënte këtë pa u pikasur nga NATO, që i di kapacitetet e armëve të shteteve anëtare, dhe e gjurmon prodhimin e tyre.

NATO supozohet se është garantuesi i sovraniteteve kombëtare të Evropës. Gjermania, ekonomia kryesore e Evropës, kishte armë të mjaftueshme për të ofruar një shkallë të vogël mbështetjeje për Ukrainën. Por e vërteta e hidhur, është se lufta në Ukrainë është një konflikt relativisht i vogël, nëse pse tragjik, në tablonë e përgjithshme evropiane.

Nëse Rusia do të pushtonte gjithë Ukrainën, deri përfshirë kufirin e saj të largët perëndimor, ajo do të ishte teorikisht në pozitën për t'u zhvendosur më në Perëndim drejt vendeve të NATO-s. Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Polonia dhe potencialisht Franca, kanë aftësi të mëdha ushtarake, por Shtetet e Bashkuara do të mbanin mbi supë barrën kryesore. Nëse do të ndodhte ky skenar, do të pasonte një tjetër Luftë e Ftohtë dhe potencialisht një tjetër konfrontim me SHBA-në. Prandaj, dëshimi i Gjermanisë për të krijuar një industri të mbrojtjes në

përpjesëtim me madhësinë e ekonomisë së saj është i papërshtatshëm, dhe ngre pikëpyetje mbi pjesën tjetër të kapacitetit prodhues të Evropës.

Ky problem lindi nga miti evropian se lufta është e vjetruar, dhe se synimi kryesor i Evropës është të ndërtojë një prosperitet të përhershëm. Tek e fundit motoja e BE-së, është paqja dhe prosperiteti. E para u konsiderua si e dukshme, dhe e dyta pasoi të parën.

Evropa e ndërtoi këtë mit duke ndërtuar një gati-shtet, në formën e Bashkimit Evropian, që ishte i fokusuar vetëm në mirëqenien ekonomike, me qëllimin e shtuar krijimin e një identiteti evropian. Çështjet ushtarake iu lanë shteteve individuale. Meqenëse ato ishin anëtare të NATO-s dhe si të tilla, duhej të garantonin sigurinë ushtarake të Evropës, Uashingtoni u bë garantuesi de fakto i sigurisë evropiane.

Defiçiti ushtarak gjerman është shumë domethënës. Duke pasur parasysh pozicionin e saj si ekonomia më e madhe evropiane dhe si një anëtare e NATO-s, është e arsyeshme të pritët që Gjermania të mirëmbajë ose ndërtojë objekte të prodhimit të

armëve e nxitur nga ndjenja e përgjegjësisë.

Po ashtu ajo mund ta kishte udhëhequr BE-në në krijimin e kapaciteteve të prodhimit të armëve apo të forcimit të një ushtrie evropiane. Meqenëse Prodhimi i Brendshëm Bruto vjetor i BE-së është afërsisht i njëjtë me atë të Amerikës, kjo do t'i lejonte evropianët ta përballonin me armë dhe forca evropiane rrezikun e zhvillimit të një lufte në Ukrainë.

Meqë një luftë në Evropë ishte e paarsyeshme kur BE-ja nisi të krijohej, askush nuk donte t'afinonte një ndërmarrje të tillë, duke ia lënë atë NATO-s, dhe për rrjedhojë, Shteteve të Bashkuara. Por e vërteta është se BE-ja përbëhet nga anëtarë që nuk i besojnë shumë njëri-tjetrit.

Struktura komanduese e një ushtrie evropiane do të kontestehej ashpër, dhe do të diskutoheshin siguri edhe fuqia në rritje e disa vendeve. Është e rrezikshme të jesh i pasur dhe i dobët. Kombe të tilla shihen shpesh si një "vakt i shijshëm". Kështu u duket Evropa grabitqarëve globalë.

Shtetet e Bashkuara, që janë edhe të pasura dhe të forta, duhet ta

mbrojnë Evropën sepse pasuria, teknologjia dhe njohuritë e Evropës në duart e shteteve të tjera, mund të rrezikojnë Shtetet e Bashkuara. Evropianët e kanë zotëruar për shekuj me radhë artin e përdorimit efektiv të dobësisë.

Unë nuk e konsideroj mungesën e prodhimit ushtarak gjerman si shkak për ndonjë shqetësim real. Por në planin afatgjatë, besimi evropian se kontinenti nuk përballet dot me kërcënime, apo se do të jetë SHBA, ajo që do të marrë përsipër rrezikun dhe koston e mbrojtjes së Evropës, nuk mund të zgjasë edhe për shumë kohë.

Ndoshta është më mirë që Evropa të mbetet e dobët ushtarakisht. Historia tregon se një kontinent i armatosur mirë por i përçarë është shumë i rrezikshëm. Armatimi dhe çarmatimi janë që të dyja shqetësues. Diçka që tani nuk është një problem, mund të bëhet gjithmonë i tillë në Evropë pas disa kohësh.

Shënim: George Friedman, është një parashikues gjeopolitik dhe strateg mbi çështjet ndërkombëtare. Themelues dhe drejtor i thinj-tankut "Geopolitical Futures". / "Geopolitical Futures" – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita, tepër e fortë për Gjilanin, fiton edhe Prishtinë

Në kuadër të javës së shtatë në elitë, Drita dhe Prishtina kanë shijuar fitore ndaj Gjilanit, përkatësisht Malishevës. Në këto dy ndeshje janë realizuar 11 gola. Dy ndeshje të kësaj jave zhvillohen sot (e enjte), ndërsa ndeshja në mes të Llapit dhe Ballkanit është shtyrë

**EPOKA ERE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 14 SHTATOR** - Skuadra e Dritës e ka fituar derbin më të madh në futbollin e Kosovës ndaj rivalit lokal, Gjilanit, me rezultat 4-1. Skuadra e drejtuar nga trajneri Ardian Nuhii realizoi tri gola në pjesën e parë, duke konfirmuar se në këtë ndeshje tri pikët janë të tyre. Marko Simonovskin realizoi dy gola, ndërsa Blendi Baftiu e shtoi një tjetër. Në pjesën e dytë Drita realizoi edhe një gol nëpërmjet Simonovskit që e komplotoi tregolëshin, kurse Gjilani e shënoi golin e nderit me anë të Baton Zaberxhës. Drita me tri pikët e reja shkon në kuotën e 14 pikëve, aq sa ka edhe skuadra e Gjilanit, por Drita ka një ndeshje më pak të zhvilluar. Në ndeshjen tjetër që është

zhvilluar të mërkurën në mes të Prishtinës dhe Malishevës janë shënuar gjashtë gola, derisa skuadra kryeqytetase ka fituar me rezultat 4-2. Mëndurim Hoti realizoi golin e parë pas tre minutave lojë, kurse Kreshnik Uka e shtoi epërsinë në 2-0. Endrit Krasniqi realizoi nga penalltia për rezultatin 3-0, kurse golin e katërt e shënoi Gashi. Për mysafirët shënues në pjesën e parë ishte Alban Shillova nga penalltia. Në pjesën e dytë krejt çka arritën mysafirët

SUPERLIGA - JAVA 7	
Drita - Gjilani	4-1
Prishtina - Malisheva	4-2
<b>Të enjten takohen:</b>	
15:00 Dukagjini - Drenica	
15:00 Trepça '89 - Ferizaj	
15:00 Llapi - Ballkani (është shtyrë)	



ishte edhe shënimi i golit të dytë, katër minuta pa përfunduar ndeshja nëpërmjet Hajdarit. Pas kësaj ndeshjeje, skuadra e Ismet Munishit ka grumbulluar 11 pikë, derisa Malisheva mbetet në kuotën e 7

pikëve. Sot do të zhvillohen dy ndeshje të tjera. Në Klinë Dukagjini e pret Drenicën. Të dyja këto skuadra nuk e kanë nisur në mënyrë të mirë këtë edicion të garave dhe do të kërkojnë fitore,

kurse në Mitrovicë Trepça '89 e pret Ferizajn. Ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Ballkanit është shtyrë për faktin se kampionët e Superligës sonte (e enjte) do të përballen me Slavia Pragën në kuadër të Ligës së Konferencës.

## Çeku: Është interes kombëtar ta kemi stadiumin e Gjilanit me standarde ndërkombëtare

**GJILAN, 14 SHTATOR** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim punë ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, prej të cilit ka marrë mbështetjen për realizimin e disa projekteve të përbashkëta dhe të projekteve që janë nisma të komunës së Gjilanit. "Diskutuaam rreth projekteve që janë në zhvillim e sipër e për projektet dhe idetë e reja që ne si komunë mendojmë t'i realizojmë. Është një qasje e re e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por në të njëjtën kohë edhe ne si komunë po mundohemi që të jemi sa më kreativë që është e mundur që t'i plotësojmë nevojat elementare e bazike për komunitetin sportiv e artistik", ka deklaruar, pas takimit, kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni. "Po ashtu, sot e kam shfrytëzuar rastin që ta njoftoj ministrin Çeku për zhvillimin e punimeve në palestrën e sporteve në Zhegër për situatën rreth stadiumit të qytetit, duke e ditur faktin se ministri që nga fillimi i mandatit një prej top prioritetëve e ka pasur zgjidhjen e problemit të këtij stadiumi. Detajet që i kemi nxjerrë dhe që janë qartësuar për opinionin



kanë treguar për defektet e mëdha në stadiumin e Gjilanit. Tash kemi arritur në një fazë që projektit po i jepet energji e re dhe frymë e re dhe në të njëjtën kohë do të qartësohen edhe problemet e fundit në mënyrë që stadiumi i qytetit të fillojë të punohet sa më shpejt që të jetë e mundur", ka shtuar kreu i Gjilanit. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, pasi e ka falënderuar kryetarin Hyseni për pritjen, ka thënë se në Gjilan ka ardhur për t'i dinamizuar projektet e investimeve kapitale, programet e tjera të përbashkëta e projektet e reja të

sportit, artit e rinisë. Ministri Çeku tha se Gjilani e ka pasur dhe do ta ketë primatin e investimeve në trashëgiminë kulturore, ndërkaq ka konfirmuar se mbështetjen ndaj nismës së komunës së Gjilanit për ta shndërruar Kalanë e Pogradit dhe gjithë ambientin aty në atraksion turistik. Për palestrën e Zhegërës, ministri Çeku tha se janë duke u kujdesur në veçanti, duke shtuar se tashmë ky projekt po shkon në fazën përfundimtare të realizimit të punimeve në mënyrë që të jetë në shërbim të sportistëve e rinisë. Duke folur për stadiumin e qytetit,

ministri Çeku ka thënë se tashmë kemi hyrë në fazën e zgjidhjes së këtij ngërçi afatgjatë, duke shtuar se është interes kombëtar që ta kemi të përfunduar këtë stadium në kohën më optimale me standardet e përbushura ndërkombëtare. "Sa i përket stadiumit, tashmë kemi hyrë në fazën e zgjidhjes së këtij ngërçi afatgjatë, fatkeqësisht. Kemi filluar fazën e hartimit të projektit për fazën përfundimtare të ndërtimit të stadiumit të qytetit, i cili përfundimisht na e nxjerr koston, rugën dhe na tregon kohën që na duhet për ta realizuar përfundimisht këtë investim shumë të rëndësishëm jo vetëm për Gjilanin, sepse një stadium i këtillë i duhet edhe Kosovës, sidomos për garat ndërkombëtare. Është interes kombëtar që ta kemi të përfunduar këtë stadium në kohën më optimale me standardet e përbushura ndërkombëtare", ka deklaruar ai. "Ky projekt nuk ka ekzistuar asnjëherë sepse është punuar me faza dhe asnjëherë nuk ka pasur projekt përfundimtar. Në momentin që e kemi projektin profesional me të gjitha standardet, do të kalojmë në kontraktimin e punimeve dhe do të

bëjmë më të mirën që brenda kohës më optimale, në bashkëpunim me kryetarin e komunës, të vazhdojmë ta trajtojmë me shumë prioritet përfundimin e punimeve në stadiumin e Gjilanit", ka shtuar ministri Çeku. Ministri i MKRS-së ka thënë po e shqyrtojnë mundësinë e mbështetjes edhe ndaj nismës së komunës për projektin "xhepat e gjelbër të lagjeve" për ta bashkëfinancuar ndërtimin e fasiliteve sportive dhe kulturore, por edhe për projektin tjetër të komunës për Qendrën e Kulturës, derisa ka dhënë zotimin për bashkëfinancim edhe të manifestimit kulturor mbarëkombëtar "Flaka e Janarit 2023". Në fund, ministri Çeku tha se nga kryetari Hyseni ka kërkuar lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e palestrës së xhudos dhe për ndërtimin e një shtëpie të shahut. "Tashmë kryetari Hyseni është në komunikim edhe me federatat përkatëse dhe në momentin që i kemi lokacionet, ne do t'i nisim procedurat për ndërtimin e këtyre palestrave të reja, një për xhudon e një për shahun", ka thënë ministri Çeku.

## Ibra: Ende kam uri, dëshira ime është të kem ende suksese

MILANO, 14 SHTATOR - Zlatan Ibrahimoviç kërkon pak durim, kërkon pak më shumë kohë përpara se të bashkohet me grupin, në të njëjtën kohë qetëson tifozët duke theksuar se ndihet mirë dhe se ka ende uri. Në këtë periudhë që ka qenë i dëmtuar, Ibra ka pasur mundësi

të reflektojë gjatë për të ardhmen. Sulmuesi suedez e ka të qartë projektin e tij të ri, të bëhet trajner, por kjo kohë nuk ka ardhur ende pasi mendon se mund të japë kontribut në fushë. "Nëse them se dëshiroj të bëj diçka, atëherë duhet ta bëj me çdo kusht. Nëse mendoj të

bëhen trajner, do të thotë se më duhet ta lë futbollin, por nuk është kështu. Kam ende uri. Dëshira ime është të kem ende suksese si lojtar", u shpreh Ibra. Pa Ibrën në dispozicion, Milani vijon garën në dy fronte, Serinë A dhe Ligën e Kampionëve: "Shokëve u kërkoj rezultate në

çdo ndeshje, edhe disiplinë. Do të ishte bukur nëse shkojmë në 1/8 e Ligës së Kampionëve, por duhet të mendojmë ndeshje pas ndeshje. Kjo kërkon një impenjim të madh pasi në të njëjtën kohë duhet të mendojmë edhe për kampionatin".



## 'Street Fest 2022' në qendër të Prishtinës

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Më 15 dhe 16 shtator do të organizohet turneu i streetbollit në qendër të Prishtinës (sheshi "Zahir Pajaziti"), ku pritet një spektakël, pasi do të ketë gara te seniorët, femrat, për fëmijë (pionierë, kadetë dhe juniorë) dhe për persona me aftësi të veçanta. Përveç streetbollit do të ketë shumë befasi për të ftuarit, ku do të ketë lojëra shpërblyese, vallëzim e muzikë. Turneu organizohet nga organizata "Sport4all", i mbështetur nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe komuna e Prishtinës. Të enjten do të organizohen garat nga ora 18:00. Fillimisht do të jetë ceremonia hapëse, ku do të flasin kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, drejtori i "Sport4all", Fatos Bajçinovci dhe drejtori i Sportit në komunën e Prishtinës, Granit Rugova. Në ditën e parë do të garojnë juniorët, femrat, si dhe ndeshjet e para në kategorinë e seniorëve, kurse në ditën e dytë do të garojnë pionierët (djem dhe vajza), katedët (djem dhe vajza), juniorët, personat me aftësi të veçanta, finalja e femrave dhe në



fund finalja e meshkujve, ku janë pjesëmarrës edhe kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama.

Në fund do të jetë ceremonia mbyllëse, ku do të jepen medaljet dhe mirënjohjet për pionierët, kadetët, juniorët, femrat, personat me aftësi të veçanta dhe meshkujt.

## Shqipëria konfirmon miqësoren ndaj Arabisë Saudite

TIRANË, 14 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë një miqësore me Arabinë Saudite më 26 tetor 2022. Departamenti i Komunikimit në FShF bëri me dije se është arritur marrëveshja me Federatën e Futbollit të Arabisë Saudite për të luajtur një ndeshje në qytetin e Abu Dabit në Emiratet e Bashkuara Arabe. Ora dhe stadiumi ku do të luhet kjo miqësore mbeten ende për t'u përcaktuar pas diskutimeve finale mes dy federatave. Kjo do të jetë ndeshja e parë në histori në mes të Shqipërisë dhe Arabisë Saudite, që nuk janë përballur më parë në të kaluarën në futboll. Në muajt e ardhshëm, deri në fillimin e Botërorit "Katar 2022", Shqipëria do të luajë edhe miqësore të tjera sipas kalendarit të FIFA-s, teksa FShF po punon për t'i zyrtarizuar edhe rivalët e radhës. Në muajin shtator Kombëtarja



Shqiptare do t'i luajë dy përballjet e fundit të grupit në Ligën e Kombeve. Më 24 shtator kuqezinjët përballen në transfertë me Izraelin,

ndërsa më 27 shtator do ta presin Islandën në stadiumin "Air Albania" të Tiranës. Më pas do të jetë radha e ndeshjeve miqësore.

### SHKURT

#### Më 20 tetor zhvillohet ndeshja Arsenal - PSV

Sfida në mes të Arsenalit dhe PSV-së, e parashikuar të luhej më 15 shtator, e vlefshme për fazën e grupeve të Ligës së Evropës, është shtyrë për shkak të vdekjes së Mbretëreshës Elizabeth II. Tashmë është marrë vendimi nga UEFA. Ky takim do të luhet më 20 tetor, ndërsa në këtë datë është parashikuar të luhet përballja mes "topçinjve" dhe Manchester Cityt. Në këto kushte, dueli në mes të Arsenalit dhe Cityt do të shtyhet për një moment tjetër, pasi më parë do të zhvillohet përballja në Ligën e Evropës.

#### Xavi: Jam i inatosur, krijuam plot raste dhe nuk shënuam

Bayern Muncheni mund të quhet si "macja e zezë" e Barcelonës, pasi edhe këtë herë katalanasit u mposhtën nga skuadra gjermane me shifrat 2-0 në një takim që ishte i luftuar deri në sekondat e fundit. Pas kësaj disfate, Xavi Hernandez ishte shumë i inatosur me të vetët, pasi blaugranat arritën të krijojnë plot raste, por nuk i shfrytëzuan siç duhet. "Ne kemi qenë më të mirë në intensitet, edhe fizikisht. Pjesa e parë ishte e shkëlqyer. Nuk mund të humbësh një ndeshje të tillë. Ishte një ditë për të fituar, jo për të barazuar. Jam i inatosur. Ne kemi krijuar shtatë raste dhe nuk kemi shënuar asnjë gol. Mëkat! Duhet të përmirësohemi në zonë. Jam i mërziur. Nuk më pëlqen të humbas. Nuk e kemi merituar fitoren. Ne kemi qenë më të mirë se Bayerni. Kemi krijuar shumë raste", ka thënë Xavi.

#### Verstappen mund të shpallet kampion në garën e ardhshme

Kur kanë mbetur edhe 6 gara nga përfundimi i sezonit 2022 në Formula 1, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, ka 116 pikë avantazh ndaj Charles Leclerc dhe 125 ndaj shokut të tij të skuadrës Sergio Perez. Një avantazh i konsiderueshëm, duke mbyllur teorikisht garën për titullin kampion për pilotë këtë sezon. Vetëm ndonjë çudi e madhe e ndan Verstappenit nga titulli i dytë kampion radhazi, i cili mund të vijë që garën e ardhshme në Singapor. Në rast se holandezi fiton në garën e radhës, duke realizuar edhe xhiron e shpejtë, ndërsa Leclerc renditet i teti dhe Perez i katërti, atëherë do të kemi një kampion që pas 10 ditësh. Verstappen shpallet kampion bote edhe pa xhiron e shpejtë, por në këtë rast Leclerc duhet të renditet i nënti dhe Perez i katërti. Gjithsesi, pavarësisht prej kombinimeve, titulli kampion është çështje e mbyllur dhe holandezi herët a vonë do të festojë. Ndoshta në Japoni (Suzuka) apo Amerikë (Austin), ku zhvillohen garat e radhës.

#### James pritet të kalojë tek Olympiacosi

Mesfushori kolumbian James Rodriguez pritet të bëjë një tjetër lëvizje. Lojtari nuk është rehatuar së fundmi me skuadrat e tij dhe tashmë pritet të bëjë një tjetër lëvizje. Sipas raportimeve të Fabrizioo Romanos, James është pranë transferimit tek Olympiacosi. Ylli kolumbian do të udhëtojë drejt Greqisë sot. Testet mjekësore janë caktuar dhe ka një marrëveshje verbale në parim, për një huazim.

## Ronaldo refuzoi ofertën prej 242 milionë eurosh nga Arabia Saudite

Cristiano Ronaldo ka refuzuar një ofertë "faraonike" që do ta bënte atë sërish futbollistin më të paguar në botë. Pasditen e së hënës në Portugali u përhap lajmi se Al-Hilal i kishte ofruar

një kontratë prej 242 milionë eurosh për dy sezone. Pavarësisht kësaj oferte të pazakontë, Ronaldo është i bindur të qëndrojë te Manchester Unitedi të paktën

për muajt e ardhshëm. CR7 dëshiron të vazhdojë të konkurrojë në nivelin më të lartë të futbollit. Synimi i tij ishte që të gjejë një ekip të rëndësishëm pjesëmarrës në

Ligën e Kampionëve. Portugezi nuk është në momentin më të mirë, por objektivi i tij është të jetë në formën më të mirë në Botërorin "Katar 2022", që do

të nisë pas dy muajsh. Al-Hilal është një ekip nga qyteti i Riadit, i cili nuk ka ngurrar të bëjë një ofertë absolutisht të parezistueshme për këdo: 121 milionë euro në vit.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rishpall:

### KONKURS

**Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

#### Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhen nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

#### Funksionet e Këshillit :

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;
- Mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

**Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

#### Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhen për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

#### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

### PROCEDURA E KONKURRIMIT

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 4 tetor 2022, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

#### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

**Forma e shtypur:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

**Forma elektronike:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova ponovo raspisuje:

### KONKURS

**Za izbor dva (2) člana Nezavisnog nadzornog odbora za Civilnu službu Kosova, iz ne albanske zajednice**

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

#### Sastav Odbora

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova. Od toga, najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

#### Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa, odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

**Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:**

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje deset (10) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje pet (5) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosudnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljavanja iz civilne službe.

#### Mandat članova Odbora

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju, da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

#### Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- Curriculum Vitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

### PROCEDURA KONKURISANJA

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 4. oktobar 2022. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

#### Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

**Štampana forma:** u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

**Elektronskom obliku:** internet-stranica Skupštine Republike Kosova - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

## KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave

### Përgjegjësitë dhe kompetencat

Bordi për Ankesa shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së, që drejtpërdrejt i nënshtrihen vendimit, sa i përket:

- Dhënies, refuzimit, mosripërtërimit ose revokimit të lejes transmetuese;
- Vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
- Shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera të ngjashme, që mbështeten në aktet nënligjore;
- Bordi i Ankesave mund të mbështesë, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të KPM-së, duke vepruar sipas ankesës për vendimin përkatës.

### Kandidatët për anëtarë të Bordit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të kenë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Të kenë së paku diplomë universiteti në fushën e drejtësisë;
- Të kenë provimin e dhënë të juridikut;
- Të kenë minimum pesë (5) vjet përvojë profesionale në fushën e avokaturës, çështjeve gjyqësore, ligjit administrativ, rregullimin e mediave apo politikën rregullative;
- Të jenë figura eminente, me karakter dhe moral të lartë, paanshmëri e integritet, përkushtim të dëshmuar të administrimit të duhur të drejtësisë;
- Të mos kenë pengesa në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Kandidatët të plotësojnë dhe nënshkruajnë vetë-deklaratën, që i përmbushin të gjitha kriteret e pranueshmërisë në nenin 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjedhen vetëm edhe për një mandat tjetër.

### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Letra motivuese;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Deklaratën e plotësuar dhe të nënshkruar;
- Certifikatën që kandidati nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj).

## PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 29 shtator 2022, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

**Forma e shtypur:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

**Forma elektronike:** faja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova raspisuje:

## KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Borda za žalbe medija

### Odgovornosti i nadležnosti

Bord razmatra žalbe stranaka protiv odluka NKM-a, koje neposredno podležu odlukama koje se odnose na:

- Izdavanje, odbijanje, ne produžavanje ili oduzimanje dozvola za emitovanje;
- Postavljanje ili izmenu uslova dozvole emitovanja, izuzev uslova koji se odnose na određivanje frekvencija ili drugih tehničkih kriterija;
- Izricanje sankcija i slično, na osnovu pod zakonskih akata.
- Bord za žalbe može podržati, izmeniti ili staviti van snage svaku odluku NKM-a, postupajući prema žalbi protiv određene odluke.

### Kandidati za člana Borda moraju ispuniti sledeće uslove:

- Mora biti državljanin Republike Kosova i stalno nastanjeni na Kosovu;
  - Da imaju minimum univerzitetsku diplomu iz oblasti prava;
  - Da imaju položen pravosudni ispit;
  - Da imaju najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti advokature, sudstva, uprave, regulisanju medija ili u regulatornoj politici;
  - Da su eminentne ličnosti visokog karaktera, morala, integriteta, nepristrasni i dokazano privrženi administriranju pravde;
  - Da nemaju prepreka u smislu člana 39 Zakona o NKM;
- Kandidati popune i potpišu svoju deklaraciju, da ispunjavaju sve uslove saglasnosti u skladu sa članom 39. Zakona o nezavisnoj Komisiji za medije.

Članovi Odbora za žalbe imenuju se trogodišnjim mandatom uz mogućnost reizbora za samo još jedan mandat.

### Uz aplikaciji trebaju se priložiti sledeća propratna dokumenta:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o školskom i stručnom obrazovanju (diplome iz stranih univerziteta moraju biti nostrifikovane od Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju);
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu (prilaže i izveštaj od Trusta penzijske štednje);
- Popunjenu i potpisanu deklaraciju; i
- Certifikat da kandidat nije pod istragom (ne starije od 6. meseci).

## PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 29. septembra 2022. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

### Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

**Štampana forma:** u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

**Elektronskom obliku:** internet-stranica Skupštine Republike Kosova - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Mono Taste” SH.P.K. me pronar Denis Selmani Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811879917 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mono Taste” D.O.O. sa vllasnikum Denis Selmani Pristin, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811879917 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Mono Taste” L.L.C. with owner Denis Selmani Pristin, has come to the decision to quit its business: 811879917 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Rejhan Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” Prishtinë.

- Meli Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Bajram Hasi nga Gjakova shpall të pavlefshme letërnjoftimin me nr. Personal 1231442894.

- “Fokus Rent” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811871674.

- Agon Golaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e SH.M.T. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Marigona Kelmendi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik, drejtimi Menaxhment dhe Informatikë në UP.

- Mali Luzha nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën testit të maturës të SH.M. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Diellza Taturi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: X, XI, XII, si dhe diplomën e SH.M.F. “Gjon Nikollë Kazazi”, drejtimi – Administrim Biznesi.

- Elvis Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII,XIII dhe diplomën e SH.M. Profesionale “Gjon Nikollë Kazazi” Horti Kulturë Bujqësi.

- Ari Mamusha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës: X, XI, XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Emin Kasami shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.

- Selim Sahatqija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Medina Alija shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “Ekrem Rexha” Lubizhde.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Burim Sallauka shpall të pavlefshme diplomën shmlt “11 Marsi” Prizren.



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

